



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:093588 C. nr. 1525/2023  
Datë: 06.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420151

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, me gjyqtar Atdhe Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit: S.N.1., D.N., S.N.2., të cilët me autorizim i përfaqëson avokati S.R. nga Prizreni, kundër të paditurve M.N., A.N.1., A.N.2., A.N.3., A.K., Q.M., S.N.3., të cilët me autorizim i përfaqëson M.N., N.V., M.V., A.V.1., D.V., S.V. të cilët me autorizim i përfaqëson avokati S.V. nga Prizreni, A.V.2., H.V., A.V.3., Sh.D., E.V.1., E.V., A.V.4., dhe E.V. të gjithë nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, për vërtetimin e pronësisë, në seancën përgatitore, me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike, për shkak të vdekjes së të paditurve H.V., A.V.1., dhe S.N.3.

Procedura do të vazhdohet, pasi që trashëgimtarët e tani të ndjerave e marrin përsipër procedurën, apo kur gjykata i thërrit ta bëjnë këtë pas propozimit të palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit me padinë e paraqitur kundër të paditurit kanë kërkuar miratimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata të vërteton se paditësit janë bashkëpronar në ngastrën kadastrale nr. 1152 ZK Lubizhdë.

Në seancën përgatitore të datës 06.03.2024, palët ndërgjyqëse njoftojnë gjykatën që të paditurit e lartcekur tani janë të ndjerë. ky fakt u pohua nga të gjitha palët ndërgjyqëse.

Pasi që të paditurit H.V., A.V.1. dhe S.N.3. kanë vdekur, gjykata në kuptim të nenit 277 par. 1 germa (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ndërpreu procedurën duke i udhëzuar palët për mënyrën e vazhdimit të procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C. nr. 1525/2023 datë 06.03.2024

Gjyqtari,  
Atdhe Berisha

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.